**R E P U B L I K A  E  SH Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA VLORË**
**DREJTORIA E URBANISTIKËS**

# SPECIFIKIMET TEKNIKE

## Rikonstruksioni i "Rrapit në Ujë të Ftohtë", Bashkia Vlorë

| | |
|---|---|
| **DREJTOR I URBANISTIKËS** | **PROJEKTUES** |
| Ingli Xhaferaj | Inxh. Dejvid Myrtaj |

## 1. QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT

Ky dokument përcakton specifikimet teknike minimale të materialeve, aparaturave dhe instalimeve elektrike për sistemin e ndriçimit dekorativ e arkitektonik dhe komandimin elektrik të objektit "Rrapi në Ujë të Ftohtë" në Bashkinë Vlorë. Projekti përfshin ndriçimin e rrapit historik dhe të sheshit përreth, ndriçimin e ngulitur në zonën e shatërvanit, si dhe komandimin automatik të ndriçimit dhe të pompës së shatërvanit. Çdo Operator Ekonomik duhet të plotësojë ose të tejkalojë këto specifikime.

Operatori Ekonomik ka detyrimin të dorëzojë dokumentacionin teknik (datasheet, certifikata, deklarata të përshtatshmërisë) për të gjitha materialet e propozuara para fillimit të punimeve. Aprovimi nga projektuesi është i detyrueshëm për materiale të ndryshme nga ato të specifikuara.

Për shkak të vendndodhjes së objektit në afërsi të ujit (burimi/shatërvani), të gjitha pajisjet dhe lidhjet elektrike duhet të garantojnë klasa mbrojtjeje të larta ndaj ujit dhe pluhurit (IP66/IP67/IP68), ndërsa ndriçimi dekorativ ushqehet me tension të ulët të sigurt (24VDC).

## 2. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MATERIALEVE DHE PAJISJEVE

### 2.1 Shirit LED Fleksibël (Outdoor, 24VDC)

| Nr. | PARAMETRI / KARAKTERISTIKA | NJËSIA | VLERA / LIMITI | KËRKESA | SHËNIM |
|---|---|---|---|---|---|
| **A. KARAKTERISTIKAT ELEKTRIKE** | | | | | |
| 1 | Tensioni i ushqimit | V | 24 VDC | 24 VDC | Tension i ulët i sigurt (SELV) |
| 2 | Fuqia për metër | W/m | 10 | 10 W/m | Ndriçim linear |
| 3 | Gjatësia totale | ml | 25 | 25 ml | + aksesorë montimi |
| **B. KARAKTERISTIKAT OPTIKE** | | | | | |
| 4 | Temperatura e ngjyrës CCT | K | 3000 | 3000 K | E bardhë e ngrohtë |
| 5 | Indeksi i riprodhimit CRI | - | >= 80 | Min. Ra >= 80 | |
| **C. KARAKTERISTIKAT FIZIKE DHE MEKANIKE** | | | | | |
| 6 | Klasa e mbrojtjes IP | - | >= IP66 | Min. IP66 | Për ambient të jashtëm |
| 7 | Mbështjellja / materiali | - | Silikon/PU | Rezistent UV & ujë | Anti-UV, outdoor |
| 8 | Aksesorët e montimit | - | Profil/kapëse/konektorë | Komplet | Për fiksim dhe lidhje |
| **D. JETËGJATËSIA DHE GARANCIA** | | | | | |
| 9 | Garancia e produktit | vit | >= 2 | Min. 2 vjet | |
| 10 | Certifikatë CE | - | E detyrueshme | Kërkesë | |

### 2.2 Spot Inkaso (Ndriçues i Ngulitur në Tokë, IP68)

| Nr. | PARAMETRI / KARAKTERISTIKA | NJËSIA | VLERA / LIMITI | KËRKESA | SHËNIM |
|---|---|---|---|---|---|
| **A. KARAKTERISTIKAT ELEKTRIKE** | | | | | |
| 1 | Tensioni i ushqimit | V | 24 VDC | 24 VDC | |
| 2 | Fuqia nominale | W | 1 - 2 | 1-2 W | |
| | | | | | |

| Nr. | PARAMETRI / KARAKTERISTIKA | NJËSIA | VLERA / LIMITI | KËRKESA | SHËNIM |
|---|---|---|---|---|---|
| **B. KARAKTERISTIKAT OPTIKE** | | | | | |
| 3 | Temperatura e ngjyrës CCT | K | 3000 | 3000 K | E bardhë e ngrohtë |
| 4 | Indeksi i riprodhimit CRI | - | >= 80 | Min. Ra >= 80 | |
| **C. KARAKTERISTIKAT FIZIKE DHE MEKANIKE** | | | | | |
| 5 | Klasa e mbrojtjes IP | - | >= IP68 | Min. IP68 | I zhytshëm / kalueshëm |
| 6 | Materiali i trupit | - | Inox 316 | Stainless steel AISI 316 | Anti-korrozion |
| 7 | Forma | - | Rrethore | Rrethore | |
| 8 | Diametri i jashtëm | mm | 40 - 60 | 40-60 mm | |
| 9 | Thellësia e ngulitjes | mm | 50 - 80 | 50-80 mm | Me gotë betoni |
| **D. TË TJERA** | | | | | |
| 10 | Sasia | copë | 12 | 12 copë | |
| 11 | Certifikatë CE | - | E detyrueshme | Kërkesë | |

## 2.3 Spot Lulishte (Spike) me Llambë GU10

| Nr. | PARAMETRI / KARAKTERISTIKA | NJËSIA | VLERA / LIMITI | KËRKESA | SHËNIM |
|---|---|---|---|---|---|
| **A. TRUPI NDRIÇUES (SPOT LULISHTE)** | | | | | |
| 1 | Tensioni i ushqimit | V | 220 - 240 VAC | 230 V / 50 Hz | |
| 2 | Baza e llambës | - | GU10 | GU10 | |
| 3 | Materiali i trupit | - | Alumin/plastic | Alumin/plastik | Ngjyra e zezë |
| 4 | Klasa e mbrojtjes IP | - | >= IP65 | Min. IP65 | Për ambient të jashtëm |
| 5 | Montimi | - | Spike (ngulës) | Ngulës në tokë | |
| **B. LLAMBA GU10 (LED)** | | | | | |
| 6 | Tensioni | V | 220 - 240 | 230 V | |
| 7 | Fuqia | W | 5 - 8 | 5-8 W | LED |
| 8 | Temperatura e ngjyrës CCT | K | 3000 | 3000 K | E bardhë e ngrohtë |
| 9 | Indeksi CRI | - | >= 80 | Min. Ra >= 80 | |
| **C. TË TJERA** | | | | | |
| 10 | Sasia | copë | 4 | 4 copë (me llambë) | |

## 2.4 Transformatorët / Ushqyesit LED (24VDC)

Në sistem parashikohen dy njësi ushqimi (transformatorë) me të njëjtat kërkesa cilësore; ndryshon vetëm fuqia nominale: 300 W për linjën e shiritit LED dhe 100 W për linjën e spoteve inkaso.

| Nr. | PARAMETRI / KARAKTERISTIKA | NJËSIA | VLERA / LIMITI | KËRKESA | SHËNIM |
|---|---|---|---|---|---|
| **A. KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME (TË DYJA NJËSITË)** | | | | | |
| 1 | Tensioni hyrës | V | 220 - 240 VAC | 230 V / 50 Hz | |
| 2 | Tensioni dalës | V | 24 VDC | 24 VDC | |

| Nr. | PARAMETRI / KARAKTERISTIKA | NJËSIA | VLERA / LIMITI | KËRKESA | SHËNIM |
|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Klasa e mbrojtjes IP | - | >= IP67 | Min. IP67 | |
| 4 | Gjatësia maksimale | mm | <= 250 | Max. 250 mm | |
| 5 | Temperatura punuese | °C | >= 60 | Min. 60 °C | |
| 6 | Mbrojtjet | - | Mbingarkesë, lidhje e shkurtër, mbinxehje | Kërkesë | |
| **B. NJËSITË E PARASHIKUARA** | | | | | |
| 7 | Transformator 300 W | copë | 300 W | 1 copë | Ushqim shiriti LED |
| 8 | Transformator 100 W | copë | 100 W | 1 copë | Ushqim spot inkaso |
| 9 | Certifikatë CE | - | E detyrueshme | Kërkesë | |

## 2.5 Kuadri Elektrik i Komandimit (Panel K01)

| Nr. | PARAMETRI / KARAKTERISTIKA | NJËSIA | VLERA / LIMITI | KËRKESA | SHËNIM |
|---|---|---|---|---|---|
| **A. KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME** | | | | | |
| 1 | Tensioni nominal | V | 230 | 230 V AC njëfazor | |
| 2 | Frekuenca | Hz | 50 | 50 Hz | |
| 3 | Sistemi i neutrit | - | TNS | TN-S / TNS | |
| 4 | Icc e ushtruar në kuadro | kA | 4.8 | >= 4.8 kA | |
| 5 | Klasa e izolacionit (IP) | - | IP 55 | Min. IP 55 | Kasa e jashtme IP65 (E-04) |
| 6 | Montimi i kutisë | - | Metalik/plastik | Metalik/plastik | Trashësia e kasës >= 2 mm |
| 7 | Normat e references | - | CEI EN 60947-2; 60439-1; 23-48/49/51 | Kërkesë absolute | |
| **B. APARATURA E MBROJTJES DHE KOMANDIMIT** | | | | | |
| 8 | Automat kryesor Q01 | A/P | 20 A - 2P | C20a, 2P | Kurba C |
| 9 | SPD (shkarkues mbitensioni) | - | Kl. II, In >= 5 kA | Kërkesë | |
| 10 | Q01.1 Llambë sinjalizuese | - | 110 - 230 V | STI (sinjalizim) | Prania e tensionit |
| 11 | Q01.2 Linja e spoteve (L01) | A/P | 10 A - 1P+N | C10a + Dif. Vigi 0.03A tip A si | Kontaktor K1 |
| 12 | Q01.3 Linja LED (L02) | A/P | 10 A - 1P+N | C10a + Dif. Vigi 0.03A tip A si | Kontaktor K2 |
| 13 | Q01.4 Sensori i muzgut | A/P | 6 A - 1P+N | C6a (RNPE) | Ushqim fotoelementi |
| 14 | Q01.5 Pompa e shatërvanit | A/P | 10 A - 1P+N | C10a (SNPE) | Kontaktor K3 |
| **C. KOMANDIMI** | | | | | |
| 15 | Kontaktor | - | Komplet me santeri | Kërkesë | |
| 16 | Fotoelementi (sensor muzgu) | - | 230 V, IP 54 | Min. IP 54 | Komandim automatik |

*Shënime plotësuese për kuadrin (sipas fletës E-04): dera pajiset me dorezë me çelës/dryn; kuadri vendoset mbi një bazament betoni të ndërtuar në lulishte; kasa metalike duhet të tokëzohet; ngjyra e kuadrit e bardhë; paneli emërtohet sipas projektit (K01).*

## 2.6 Kabllot dhe Përçjellësat

| Nr. | PARAMETRI / KARAKTERISTIKA | NJËSIA | VLERA / LIMITI | KËRKESA | SHËNIM |
|---|---|---|---|---|---|
| **A. KABLLO NDRIÇUESISH (FLEKSIBËL)** | | | | | |
| 1 | Tipi | - | H05RN-F | 3x1.5 mm² | Gomë, fleksibël |
| 2 | Seksioni i përçjellësit | mm² | 3 x 1.5 | 3G1.5 | |
| 3 | Tensioni nominal | V | 300/500 | Min. 300/500 V | |
| 4 | Gjatësia | ml | 78 | ~78 ml | Lidhje spotesh/LED |

## 2.7 Aksesorët e Instalimit dhe Izolimit

| Nr. | PARAMETRI / KARAKTERISTIKA | NJËSIA | VLERA / LIMITI | KËRKESA | SHËNIM |
|---|---|---|---|---|---|
| **A. KUTITË DHE KONEKTORËT** | | | | | |
| 1 | Kuti shpërndarëse e jashtme | copë | 100x100, me gominë | 3 copë, min. IP65 | Pa tapa plastike |
| 2 | Konektor IP68 (H05RN-F) | copë | IP68, 3x1.5 mm² | 4 copë | Lidhje e papërshkueshme |
| 3 | Konektor kabëll-kuti PG11 | copë | PG11 | 20 copë | Presatrafto (cable gland) |
| **B. MATERIALET E IZOLIMIT** | | | | | |
| 4 | Xhel bikomponent A + B | l | Rezinë izoluese A+B | 1 l | Izolim lidhjesh në lagështi/ujë |

## 2.8 Infrastruktura Nëntokësore dhe Pusetat

| Nr. | PARAMETRI / KARAKTERISTIKA | NJËSIA | VLERA / LIMITI | KËRKESA | SHËNIM |
|---|---|---|---|---|---|
| **A. TUBACIONET MBROJTËSE** | | | | | |
| 1 | Tub plastmasi | mm | Ø 22 - 26 | 56 ml | Mbrojtje kablloje |
| 2 | Tub korrugat dopjoshtresë | mm | D40 | 55 ml | HDPE/PP, IP68, nëntokë |
| 3 | Rezistenca mekanike | N | >= 450 | SN8 min. | Për tub korrugat |
| **B. PUSETAT** | | | | | |
| 4 | Pusetë betoni + tokëzues | cm | 40x40x40 | 2 copë | Kapak gize + aksesorë tokëzimi |
| 5 | Pusetë plastike | cm | 30x30x30 | 1 copë | Kapak plastik me gominë |

*Pusetat prej betoni 40x40x40 përfshijnë aksesorët e tokëzimit; lidhjet e tokëzimit dhe degëzimet e kabllove realizohen brenda pusetave. Të gjitha lidhjet nën nivelin e tokës izolohen me xhel bikomponent dhe konektorë IP68.*

## 3. KËRKESAT PËR INSTALIMIN

### 3.1 Kualifikimet e Kërkuara

- Firma ekzekutuese duhet të ketë licencën elektrike në fuqi të kategorisë përkatëse për instalime të tensionit të ulët.
- Inxhinieri përgjegjës duhet të ketë diplomë në inxhinieri elektrike dhe eksperiencë të demonstrueshme.
- Punonjësit duhet të kenë certifikatat e trajnimit për siguri elektrike.

### 3.2 Kushtet e Ambientit të Punës

- Temperatura e ambientit gjatë instalimit: -5 °C deri +40 °C.
- Lagështia relative: max. 85% (pa kondensim).
- Ndalohet puna në kushte shiu të fortë ose stuhi.

### 3.3 Kushtet Specifike të Objektit (Afërsia me Ujin)

- Ndriçimi dekorativ ushqehet me tension të ulët të sigurt 24VDC nëpërmjet transformatorëve të dedikuar.
- Të gjitha lidhjet nën nivelin e tokës ose në zona me lagështi/ujë izolohen me xhel bikomponent dhe konektorë IP68.
- Ndriçuesit e ngulitur (spot inkaso) me klasë IP68 duhet të garantojnë papërshkueshmëri edhe në rast përmbytjeje të përkohshme.
- Mbrojtjet diferenciale (Id = 0.03 A, tip A) janë të detyrueshme për linjat e ndriçimit; kasa metalike e kuadrit tokëzohet.

### 3.4 Punimet e Dheut dhe Vendosja e Tubacioneve

- Hapja e kanaleve dhe vendosja e tubacioneve behet sipas planimetrisë së projektit (fletët E-01, E-02, E-03).
- Kabllot vendosen brenda tubave mbrojtës (korrugat D40 / plastmasi Ø 22-26 mm).
- Pusetat vendosen në nyjet e degëzimit dhe në pikat e lidhjeve për akses e mirëmbajtje.

## 4. DOKUMENTACIONI I KËRKUAR

### 4.1 Para Fillimit të Punimeve

- Të dhënat teknike (datasheet) për shiritin LED, spot inkaso, spot lulishte dhe transformatorët (parametrat optike dhe elektrike).
- Certifikatat CE për ndriçuesit dhe transformatorët.
- Të dhënat teknike për kuadrin elektrik dhe aparaturën mbrojtëse.
- Deklaratat e përshtatshmërisë për kabllot, konektorët IP68 dhe materialet izoluese.

### 4.2 Pas Përfundimit të Punimeve

- Procesverbalin e kolaudimit të instalimit elektrik (të firmosur nga të dyja palët).
- Raportet e matjeve (izolim, tokëzim, diferenciale, ndriçim).
- Dokumentacionin as-built të instalimit.
- Certifikatën e garancisë nga prodhuesi për ndriçuesit dhe transformatorët.
- Manualet e përdorimit dhe mirëmbajtjes.

**Projektoi:**
Inxh. Dejvid Myrtaj
Lic. Nr. E2194
Drejtoria e Urbanistikës — Bashkia Vlorë
Korrik 2026